



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:117860
Datë: 19.09.2024
Numri i dokumentit: 06183336

ARJ.nr.113/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Zenel Leku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve I.O., dhe L.Z., nga M., sipas autorizimit i përfaqëson U.G., Jurist nga Zyra Juridike “J”. M., kundër të paditurave Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, dhe Komuna e Mitrovicës, me bazë juridike anulim i aktit - vendimit administrativ të organit të paditur 04-430/04-0096504/22 të datës 24.10.2022, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësve, ushtruar nga i autorizuari i tyre, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.571/2024 të datës 13.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 18 Shtator 2024, merr:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditësve I.O., dhe L.Z., e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.571/2024 të datës 13.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.571/2024 të datës 13.06.2024, është vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësve I.O., dhe L.Z., e datës 10.05.2024, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1613/2024, i datës 25.04.2024, **VËRTETOHET**.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, paditësit, për mes të autorizuarit të lartë shënuar, në afat ligjor në këtë gjykatë parashetrojnë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të:

Aprovohet në tërësi kërkesëpapia e paditësit si e bazuar, të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1613/2024, i datës 25.04.2024, dhe ai i Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.571/2024 të datës 13.06.2024, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktvendimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar 04-430/04-0096504/22 të datës 24.10.2022 të paditurës Komuna e Mitrovicës, për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të pa paguara, debitori I.O., obligohet për pagesën e detyrimit tatimor të pa paguar në vlerë prej 23,778.70€, pagesën e shumës totale të gjobave të papaguara në vlerë totale prej 20,041.40€, si dhe pagesën e normës së interesit deri në ditën e marrjes së këtij vendimi në vlerë prej 2,931.85€, i cili do të vazhdoj të aplikohet deri në pagesën definitive të detyrimit tatimor. PAGESA E DETYRIMIT TATIMOR TË PAPAGUAR, GJOBAVE DHE INTERESIT TATIMOR NË LARTËSI PREJ NË SHUMË TOTALE, 46,752.03€, duhet të bëhet brenda 10 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartë cekur paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, A.nr.1613/2024, të datës 25.04.2024, në dispozitiv ka vendosur si në vijim: **HEDHET** poshtë si e pas afatshme padia e paditësve, I.O., dhe L.Z., me nën shenjë A.nr.1613/2024, e datës 22.04.2024.

Gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Gjykata në këtë rast mori parasysh Vendimin për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të pa paguara me numër 04-430/04-0096504/22, të datës 23.10.2022, të protokoluar me datë 24.10.2022 dhe ndaj këtij Vendimi është zhvilluar procedura përmbartimore pranë përmbartuesit privat dhe Gjykata Themelore në Mitrovicë me Aktvendimin numër PPP.nr.74/2023, ka aprovuar prapësimin e paditësve. Ndërsa sipas ankesës së të paditurës Komunës së Mitrovicës Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktvendimin numër CAP.nr.543/2023, të datës 14.11.2023 ka aprovuar si të themeltë ankesën e të paditurës duke ndryshuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.74/2023 dhe ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e paditësve dhe ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.1658/2022, të datës 14.12.2022. Paditësit pas zhvillimit të procedurës përmbartimore në gjykatë me datën 29.12.2023 me kërkesë i janë drejtuar të paditurës Komunës së Mitrovicës për shpalljen e aktit administrativ vendimit 04-430/04-0096504/22, të datës 23.10.2022 absolut të pavlefshëm si dhe të paligjshëm. Ndërsa me datën 20.02.2024 paditësit iu janë drejtuar me ankesë të paditurës Ministrisë së financave Punës dhe Transfereve - Komisionit për ankesa dhe parashtresa që të shpallet i pavlefshëm vendimi i Komunës së Mitrovicës me numër 04-430/04-0096504/22, të datës 23.10.2022.

Tutje thekson se: Gjykata në bazë të shkresave të dorëzuara me padi vërtetoi se, vendimi kontestues 04-430/04-0096504/22, të datës 23.10.2022, nga Komuna e Mitrovicës është marrë me datën 23.10.2022 ndaj të cilit edhe janë zhvilluar procedura përmbarimore dhe tek gjykata sipas prapësimit të parashtruar nga vet paditësit, ndërsa padinë bashkë me propozim për caktimin e masës së përkohshme ndaj vendimit të paditurës Komunës së Mitrovicës në gjykatë paditësit përmes përfaqësuesit të tyre e kanë parashtruar më datë 22.04.2024. Për të vlerësuar afatshmërinë e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjykata iu referua nenit 27.1 të LKA-së, i cili përcakton se *“padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës”*. Ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se *“Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti”*. Me vendimin e lëshuar nga e paditura Komuna e Mitrovicës, gjykata vëren se paditësit kanë qenë të njoftuar lidhur me Vendimin e marr nga e paditura Komuna e Mitrovicës dhe se ndaj vendimit kontestues është zhvilluar edhe procedura gjyqësore në procedurën përmbarimore, ndërsa të njëjtit padinë në gjykatë e kanë dorëzuar më 22.04.2024, duke e lëshuar afatin ligjor prej 30 ditësh për paraqitjen e padisë konform nenin 27 të LKA-së. Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 34.1.1.1 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit, me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 dhe 209 par.b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me hedhjen poshtë si të pas afatshme të padisë së paditësve.

Në arsyetim të aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë ndër të tjera thekson: Kolegji i Apelit, vlerëson se paditësit kanë lëshuar afatin për fillimin e procedurës gjyqësore në konflikt administrativ ashtu si parashihet me nenin 27 të LKA, padia ka mundur të paraqitet në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktit përfundimtar në procedurë administrative. Paditësit kanë kërkuar anulimin e vendimit të paditurës Komuna e Mitrovicës 04-430/04-0096504/22 të datës 24.10.2022 dhe propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës dhe pezullimin e Urdhrit përmbarimor P.nr.1658/22 të datës 14.12.2022, ndërsa paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë, me datë 22.04.2024, pra pas afatit të paraparë ligjor, duke u bazuar në nenin 27.1 të LKA-së, i cili përcakton se *“padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës”*. Ndërsa me paragrafin .2 të këtij nenin përcaktohet se *“Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i*

është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti”.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjen se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vendosur me refuzimin si të pabazuar të ankesës së paditësve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë. Kjo Gjykatë e vlerëson si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, pasi aktvendimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendojnë palët paditëse në kërkesën e tyre. Aktvendimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me hedhjen poshtë të padisë së paditësve.

Sipas nenit 27 paragraf 1 të LKA-së, përcaktohet se: *“Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës”.*

Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti”.*

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se paditësit kanë lëshuar afatin e përcaktuar ligjor, i cili është afat prekluziv për parashtrimin e padisë në gjykatë. Paditësit, as para gjykatës së shkallës së parë dhe as në procedurën ankimore nuk kanë parashtruar asnjë provë konkrete për të dëshmuar se padinë e kanë parashtruar brenda afatit ligjor.

Pretendimet e paditësve, të theksuara si në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku theksohet se: dokumenti i cili ka shërbyer që të niset procedura përmbartimore nuk mund të quhet akt administrativ sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), përkatësisht sipas nenit 143 dhe 144 të tij si dhe se akti administrativ nuk i plotëson kushtet sipas nenit 47, 52, 55 dhe 58 të LPPA-së, kolegji i Gjykatës Supreme, këto pretendime dhe të tjerat si në kërkesë i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të bazuara dhe të qëndrueshme andaj kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore në bazë të provave në shkresa të lëndës, kur vlerësojnë se paditësit kanë humbur afatin prekluziv për parashtrimin e padisë. Nga shkresat e lëndës shihet se paditësit kundër vendimit kontestues të lartë cekur, kanë parashtruar kërkesë me nr.04-430/07-0093805/23 pas më shumë se një viti, përkatësisht me datë 29.12.2023, me të cilën kanë kërkuar shpalljen e pavlefshme të aktit administrative, ndërsa padinë në gjykatë e kanë ushtruar më shumë se 3 muaj (për rreth 120 ditë), përkatësisht me datë 22.04.2024. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka shqyrtuar padinë, pasi gjykata fillimisht shqyrton lejueshmërinë dhe afatshmërinë e padisë dhe pastaj lëshohet në shqyrtim meritore të çështjes, përkatësisht në vlerësimin e ligjshmërisë së aktit administrative përfundimtar. Andaj me të drejtë, kjo gjykatë padinë e paditësve e ka hedhur poshtë si të pas afatshme, të parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Numri i lëndës: 2024:117860

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06183336

Gjykata shqyrtoj pretendimet e tjera të parashtrueseve të kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Mbi këto arsye, Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e paditësve janë jo të bazuara apo me ndikim për vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm e po ashtu edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditësve.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflike Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.113/2024, më datë 18 Shtator 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani